



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 26 Korrik 2021

Nr: 109

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 62, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 23.07.2021 PLOTËSUAR ME NR.62/1, DATË 26.07.2021 DHE
PEZULLIMIN E SHQYRTIMIT

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Relator
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilirjan RUSMALI - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë;

OBJEKT: Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 62, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 23.07.2021 plotësuar me nr.62/1, datë 26.07.2021 dhe pezullimin e shqyrtimit.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17, 18, 19 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë,

VËREN:

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 62 regj., datë 23.05.2021.

Në mbledhjen e datës 23.07.2021, ora 16:30, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 62 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), me vendimin nr. 106, datë 23.07.2021 vendosi kthimin e kërkesës ankimore nr.62 regj., të paraqitur në KQZ në datën 23.07.2021 për plotësimin e elementëve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor.

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, ka ridepozituar kërkesën ankimore 62/1, datë 26.07.2021, ora 08:20. Nga verifikimi paraprak i kërkesës rezulton se kërkesa ankimore i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementët e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Pranë KQZ-së janë depozituar edhe disa kërkesa ankimore që kanë të njëjtin objekt ankimi kundërshtimi i vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 “Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre”. Duke qenë se në vendimin nr. 430 datë 22.07.2021 të KSHZ cënohen interesat e ligjshme për 110 parti politike dhe se afati i ankimit për këtë vendim është 30 ditë dhe mund të ketë dhe kërkesa ankimore nga subjekte të tjera, KAS, vlerëson se duhet pezulluar shqyrtimi me objektin e sipërcituar derisa të përfundojë afati i ankimit 30 ditë për të gjitha partitë politike dhe më pas të shqyrtohet në një vendim të vetëm. Në zbatim të nenit 19, pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, përcaktohet se, *KAS përpara ose gjatë shqyrtimit të një ankimi administrativ, vendos shqyrtimin bashkërisht të tij me një ose më shumë ankime të tjera, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim.....*



Duke qenë se kërkesa ankimore nr.62 regj., datë 23.07.2021 me relator z. Lako është depozituar më parë në regjistrin e ankimimeve edhe kërkesat e tjera me të njëjtin objekt do të relatohen nga z. Elvin Lako. Në përfundim të afatit të ankimit të gjitha partitë politike do të njoftohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për riçeljen e shqyrtimit administrativ për të gjitha kërkesat ankimore me të njëjtin objekt.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 17, pika 3, shkronjat “a”, 18 e 19 pika 1, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 62, datë 23.07.2021 plotësuar me nr.62/1, datë 26.07.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.
2. Pezullimin e shqyrtimit administrativ deri në përfundim të afatit të ankimit 30 ditor të vendimit nr.430, datë 22.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

